



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 35, datë 14.10.2020

**PËR**  
**RISHIKIMIN E KUSHTEVE TË LEJES PËR OBJEKTIN: “RIKONSTRUKSION I**  
**NDËRTESESË EKZISTUESE DHE NGRITJE KATESH NË OBJEKTIN EKZISTUES, NË**  
**VALBONË, TROPOJË”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË TROPOJË**

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 48 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; nenit 17, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe VKM-së Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të Z. Avni Ponari, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rishikimit të kushteve të ndërtimit, të miratuara me vendimet e Bashkisë Tropojë Nr.8, datë 17.10.2017 dhe Nr.1, datë 11.02.2019, për objektin “Rikonstruksion i ndërtesës ekzistuese dhe ngritje katesh në objektin ekzistues, në Valbonë, Tropojë”, me vendndodhje në Bashkinë Tropojë, me zhvillues Z. Avni Ponari, në përputhje me Marrëveshjen për Delegim të Kompetencave, të nënshkruar më datë 07.08.2020.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave, miratuar me vendimet e përmendura në pikën 1, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur, e cila bëhet pjesë e këtij vendimi, së bashku me Marrëveshjen për Delegim të Kompetencave, të nënshkruar më datë 07.08.2020.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

BLENDI KLOSI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

